

Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl-Kzz 80/2012
14 qershor 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Dr. Horst Proetel si kryetar i kolegjit, dhe gjyqtarëve të EULEX-it Tore Thomassen dhe Gerrit-Marc Sprenger, gjyqtarëve të Gjykatës Supreme Marije Ademi dhe Nesrin Lushta si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore Chiara Rojek në cilësi të procesmbajtëses,

Në lëndën penale kundër **S.P.**, [nofka], [i biri i], [i lindur], [në fshatin], [shtetas i], [banor i], në paraburgim prej 3 shkurt 2010,

I akuzuar sipas aktakuzës PPS nr. 23/2010 – GJPP nr. 11/2010 të ngritur më 16 korrik 2010 nga prokuroria speciale e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë për veprat penale të Krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 3 të Kodit Penal të Kosovës (KPK) lidhur me veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së,

I dënuar në shkallë të parë me aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 36/2010 të datës 23 shkurt 2011, me të cilin S.P. u shpall fajtor për vepër penale të Krimit të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 1 të KPK-së dhe Blerje, posedim, shpërndarje dhe shtije të paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së, me dënim unik me tetë (8) vjet burgim dhe me 51.00 euro gjobë, dënim i konfirmuar në shkallë të dytë me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 255/2011 të datës 18 janar 2012,

Duke vepruar sipas Kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga avokati mbrojtës A.V. në emër të të pandehurit S.P. më 3 maj 2012 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 36/2010 të datës 23 shkurt 2011 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 255/2011 të datës 18 janar 2012, dhe duke marrë parasysh Përgjigjen ndaj kërkesës të paraqitur nga Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK) më 28 maj 2012, pas votimit dhe këshillimit të mbajtur më 14 qershor 2012,

Në përputhje me nenet 451 dhe tutje të KPPK-së, lëshon këtë

AKTGJYKIM

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga avokati mbrojtës A.V. në emër të të pandehurit S.P. më 3 maj 2012 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P

nr. 36/2010 të datës 23 shkurt 2011 dhe aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 255/2011 të datës 18 janar 2012, **REFUZOHE**T si e pabazuar.

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë P nr. 36/2010 i datës 23 shkurt 2011 dhe aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Ap-Kz nr. 255/2011 i datës 18 janar 2012 **VËRTETOHEN**.

ARSYETIMI

I. Historia e procedurës

Më 16 korrik 2010, Prokuroria Speciale ngriti aktakuzën PPS nr. 23/2010 – GJPP nr. 11/2010 të datës 13 korrik 2010 në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë. Sipas aktakuzës, H.S. dhe S.P. akuzohen për veprat penale të Krimin të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 3 të KPK-së lidhur me veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së. Përveç kësaj, U.J. dhe E.M. u akuzuan për Krimin të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 1 të KPK-së lidhur me veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së.

Më 7 shtator 2010, u konfirmua aktakuza në tërësi me aktvendimin KA nr. 56/2010.

Gjykimi filloi më 8 dhjetor 2010 dhe vazhdoi gjatë janarit dhe shkurtit 2011 në prani të palëve. Më 23 shkurt 2011, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë lëshoi aktgjykimin P nr. 36/2010. I pandehuri S.P. u shpall fajtor për veprën penale të Krimin të organizuar në kundërshtim me nenin 274 paragrafin 1 të KPK-së dhe veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe e substancave psikotropike në kundërshtim me nenin 229 paragrafin 2 dhe paragrafin 4 pikën 1 të KPK-së. “[Për shkak se] në mes tetorit 2009 dhe 03 shkurtit 2010, ata, si pjesë e grupit të organizuar, në role të ndara morën pjesë në transportimin, shpërndarjen dhe shitjen e disa dërgesave me substanca narkotike për përfitim, të dërguara prej Shqipërisë në Kosovë, pastaj përmes Serbisë deri në vendin e caktuar në Bosnjë e Hercegovinë. I akuzuari H.S. kishte rolin udhëheqës organizativ në grup ku ai ishte lidhja koordinuese në mes dy anëtarëve Shqiptarë të panjohur të grupit (L. dhe D.), të akuzuarit S.P. dhe të akuzuarit E.M. Dy shqiptarët sollën marihuanë në sasi të pacaktuar në banesën e të akuzuarit E.M. në Mitrovicë, ku S.P. dhe E.M. e matën dhe mbështollën atë në paketime të vogla, pastaj i vendosën ato në çanta më të mëdha, dhe i dërguan në garazhin e shtëpisë ku dy meshkujt e panjohur i morën dhe i dërguan ato me vetura të ndryshme në vend të panjohur. Më 03 shkurt 2010, u gjetën 26.449 kilogramë kanabis (marihuanë) dhe 4.342 kilogramë të një substance pluhuri me ngjyrë kafe të çeltë me përmbajtje të një përzierje të Acetaminofenit (Paracetamol) dhe Kafeinës që mund të përdoren si përzierje për heroinë dhe droga të grupit të opiumit. Për më shumë, u gjetën edhe gjurmë të heroinës në një peshore digjitale, një shoshë dhe një sitë u konfiskuan nga shtëpia e E.M. Sasia totale e drogës së transportuar mbetet e panjohur.”

Ai u dënua me shtatë (7) vjet burgim dhe me 50.00 euro gjobë për veprën penale të Krimit të organizuar, dhe me tri (3) vjet burgim dhe me 50.00 euro gjobë për veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shtija e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm. Në përputhje me nenin 71 paragrafin 1 dhe 2 pikën 2 dhe 4 të KPK-së, ndaj tij u shqiptua dënimi unik me tetë (8) vjet burgim dhe me 51.00 euro gjobë.¹ Dy të bashkëpandehurit po ashtu u dënuan. I bashkakuzuari i katërt u lirua.

Në qershor 2011, tre të pandehurit, përfshirë edhe S.P.-in ushtruan ankesa kundër aktgjykimit P nr. 36/2010. Më 18 janar 2012, Gjykata Supreme e Kosovës lëshoi aktgjykimin Ap-Kz nr. 255/2011 me të cilin refuzohen ankesat e ushtruara nga avokatët mbrojtës, dhe vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë.

Më 3 maj 2012, avokati A.V. paraqiti Kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të S.P.-it. Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPSHK) më 28 maj 2012 paraqiti përgjigjen ndaj kësaj kërkesë.

II. Parashtresat e mbrojtjes dhe përgjigja e ZPSHK-së

1. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë

Mbrojtja paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës penale nga neni 451 paragrafi 3 lidhur me nenin 403 paragrafin 2 pikën 1 të KPPK-së, dhe i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës ta anulojë aktgjykimin e kontestuar, dhe ta kthejë lëndën në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim; dhe ta ndërpresë paraburgimin në përputhje me nenin 420 paragrafin 1 pikën 3 lidhur me nenin 424 paragrafët 1 deri 4 të KPPK-së.

Mbrojtja pohon se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë nuk kanë vepruar drejt kur shpallën të pandehurin fajtor për veprat e përmendura penale dhe kur shqiptuan dy dënime. Si pasojë e kësaj, është bërë një shkelje e rëndë e nenit 71 paragrafit 1 të KPPK-së.

Avokati A.V. pohon se S.P., bashkë me të bashkëpandehurit kanë kryer një vepër, e jo dy vepra të ndara. I pandehuri mund të shpallet fajtor vetëm për veprën penale të krimit të organizuar apo të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike, por jo për të dyja veprat penale, pasi që nuk ka pasur shumë vepra penale. Rrjedhimisht, gjykata është dashur të shqiptojë një dënim.

2. Përgjigja e Prokurorit të shtetit

Prokurori i shteti i kërkon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta refuzojë kërkesën si jomeritore sipas nenit 456 të KPPK-së. ZPSHK-ja konstaton se mbrojtja ka kërkuar vetëm anulimin e aktgjykimit të shkallës së dytë.

¹ Koha e kaluar në paraburgim nga 03 shkurti 2010 llogaritet në përputhje me nenin 73 paragrafin 1 të KPK-së. Kolegji i Gjykatës së Qarkut po ashtu lëshoi një vendim mbi konfiskimin e drogave narkotike në përputhje me nenin 60 dhe nenin 494 të KPPK-së dhe mbi mbulimin e shpenzimeve të procedurës penale.

Edhe në qoftë se supozojmë se kërkesa është e bazuar, Gjykata Supreme do të mund të ndryshonte aktgjykimin sipas nenit 457, par. 1, nën-paragrafi 1 të KPPK-së, dhe jo ta anulonte tërë aktgjykimin apo vetëm një pjesë të tij.²

Prokurori i shtetit paraqet këto argumente të tij: kjo çështje tashmë është trajtuar nga Gjykata Supreme në aktgjykimin Ap-Kz nr. 225 / 2011; dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë përmban një përshkrim të nënkuptuar të veprimeve për veprën penale të krimit të organizuar; dispozitivi duhet të lexohet së bashku me pjesën tjetër të aktgjykimit, në veçanti faqja 23 dhe pjesa tjetër nën titullin “Akuza për krim të organizuar”.

III. Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme.
Gjykata Supreme e Kosovës e refuzon kërkesën si të pabazë.

1. Kompetenca e Gjykatës Supreme të Kosovës

Gjykata Supreme e Kosovës është kompetente për të vendosur mbi kërkesën mbi mbrojtje të ligjshmërisë sipas neneve 454 dhe 26, par. 3 të KPPK-së. Kolegji i Gjykatës Supreme është formuar në pajtim me nenin 3, par. 7 të Ligjit nr. 03 / L – 053 mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë.

2. Pranueshmëria e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Aktgjykimi i fundit i kundërshtuar, aktgjykimit Ap-Kz nr. 255 / 2011 është shpallur më 18 janar 2012. I pandehuri e ka pranuar këtë aktgjykim më 26 mars 2012, ndërsa avokati A.V. më 22 mars 2012. Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë është regjistruar më 3 maj 2012.

Kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë prandaj është e pranueshme sepse është paraqitur me kohë nga personi i autorizuar sipas nenit 452, par. 3 dhe 453 të KPPK-së.

3. Meritat e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë

Si vërejtje fillestare lidhur me fushën e shqyrtimit, Prokurori i shtetit deklaron se mbrojtja ka ushtruar kërkesë kundër aktgjykimit të shkallës së dytë derisa avokati A.V. propozon vetëm anulimin e këtij aktgjykimi. Gjykata Supreme e Kosovës nuk pajtohet me këtë qëndrim. Kërkesa është paraqitur “kundër aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës në Prishtinë Kz Nr. 255 – 2011, të datës 18 janar 2012, me të cilën është refuzuar si e pabazë ankesa e avokatit mbrojtës të të pandehurit S.P., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës P. Nr. 362 / 2010, e datës 23 shkurt 2011 ...”

² Bëhet fjalë për aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Pkl - Kzz nr. 114 / 2009, mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të datës 12 prill 2010 (faqe 5 e më tej), të përmendur nga Gjykata Supreme e Kosovës, aktgjykimi Pkl - Kzz nr. 39 / 2012, mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të datës 24 prill 2012 (faqe 8 e më tej.)

Përveç kësaj, mbrojtja në mënyrë të qartë u referohet të dyja aktgjykimeve në paragrafin e parë të kësaj kërkesë. Në fund, përmbajtja e kërkesës shpalos në mënyrë të qartë pretendimet kundër të dyja aktgjykimeve. Për këtë arsye, një pretendim i tillë rreth kësaj pike refuzohet.

Gjykata Supreme, megjithatë, dëshiron të theksojë se kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë duhet të hartohet në një mënyrë që të sigurojë precizitet relativ të parashtrësive me qëllim të shqyrtimit të drejtë të lëndës.

Përveç kësaj, vërejmë se mbrojtja i referohet nenit 420, par. 1, pikës 3, lidhur me nenin 424, par. 1 deri në 4 të KPPK-së. Gjykata Supreme e Kosovës nuk sheh ndonjë rëndësi të përmendjes së këtyre dispozitave pasi që të njëjtat kanë të bëjnë me vendimet e gjykatës së apelit të shkallës së dytë, që është tjetër lëndë.

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale e përcaktuar në nenin 452, lidhur me nenin 403, par. 2, pikën 1 të KPPK-së

Mbrojtja kundërshton faktin që S.P. është shpallur fajtor dhe është dënuar për të dyja veprat penale, krimin e organizuar dhe blerjen, posedimin, shpërndarjen dhe shitjen e paautorizuar të narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike. Nga ana tjetër, Prokurori i shtetit pretendon se dispozitivi i lexuar së bashku me arsyetimin e aktgjykimit në mënyrë të qartë jep përshkrimin e fakteve për të dyja veprat penale.

Pas leximit të vëmendshëm të aktgjykimit të shkallës së parë, del në pah se ekziston vetëm një përshkrim i gjendjes faktike edhe pse i pandehuri është shpallur fajtor për dy vepra të ndara penale. Për më tepër, të dyja përkufizimet e veprave penale nuk dallohen në mënyrë të qartë në dispozitivin e shkallës së parë.

Duke aluduar në vepra dhe përkufizime juridike për të cilat një person shpallet fajtor apo lirohet, dispozitivi duhet të përmbajë gjendjen faktike për secilën vepër penale, për hir të qartësisë dhe parashikueshmërisë. Kushtet e përcaktuara me nenin 396, par. 3 dhe 4 dhe 391 lidhur me përpilimin e dispozitivit janë obligative.

Kolegji i Gjykatës Supreme, megjithatë, konsideron se dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar përmban të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj të cilat sigurojnë që dispozitivi të jetë i kuptueshëm.³ Në këtë instancë, përshkrimi faktik i dispozitivit përmban elemente të krimit të organizuar, sipas nenit 274, par. 1 të KPPK-së: elementin ligjor, vetë veprën si dhe elementin mendor. Gjithashtu, edhe për veprën penale të Narkotikëve. Gjykata e shkallës së parë në dispozitiv⁴ përmend veprat e të pandehurve dhe rolet e tyre përkatëse.

³ Shih aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap - Kz nr. 179 / 2007, mbi ankesën e datës 23 qershor 2009, faqe 25: “Ligji nuk përcakton që dispozitivi të përmbajë një përshkrim shumë të detajuar të sjelljes së personit të dënuar, sepse ky përshkrim do të trajtohet në arsyetimin e aktgjykimit. Dispozitivi megjithatë duhet të jetë “i kuptueshëm”, që do të thotë se i njëjti duhet ta bëjë të qartë atë çfarë ka bërë i pandehuri.”

⁴ Shih, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë P nr. 36/2010, aktgjykimi i shkallës së parë, faqet 2-3: “I akuzuari H.S. ka pasur rol udhëheqës organizues..”; “ku S.P. dhe E.M. kanë matur dhe mbështjellë në paketime më të vogla, pastaj i kanë vendosur në qese më të mëdha dhe i kanë dërguar në garazhin e shtëpisë nga ku dy persona meshkuj të panjohur i kanë marrë dhe i kanë dërguar ato.”)

Për më tepër, është vërejtur se gjykata e shkallës së parë ka përshtuar faktet e vërtetuara (nën pjesën E. Gjetjet faktike, faqet 21-22) dhe në mënyrë që qartë ka bërë dallimin në mes të akuzës së Narkotikëve dhe akuzës së Krimit të organizuar (nën F. Cilësimi juridik, faqet 22-24) në arsyetimin e aktgjykimit. Trupi gjykues gjithashtu ofron sqarime lidhur me përbërjen e grupit dhe rolin e secilit anëtar, natyrën e “strukturuar” të grupit, kohën e kryerjes së veprave, aktivitetet e ndryshme të grupit dhe qëllimet e tij. Gjykata Supreme gjen se dispozitivi, i lexuar së bashku me arsyetimin, jep një përshkrim të detajuar të fakteve, bazën e të dy dënimeve. Siç ka sugjeruar Prokurori, dispozitivi përmban përshkrimin e nënkuptuar të akteve për veprën penale Krim i organizuar.

Më tutje, Gjykata Supreme konsideron se Krimi i organizuar është një vepër penale e ndarë sipas Kodit Penal të Kosovës. Si rrjedhojë, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë asnjë shkëlqje të ligjit kur ka dënuar të pandehurin për të dy veprat. Kjo çështje është ngritur në fazën e ankesës nga mbrojtja dhe ky kolegji i Gjykatës Supreme plotësisht pajtohet me gjetjet e gjykatës së shkallës së dytë.⁵

Kjo vepër është e dënueshme sipas Kapitullit XXIII (Veprat penale kundër pronës) të Kodit, në mes tjerash si vepër e pavarur. Nëse ligjvënësi ka pasur për qëllim të fus faktin se i akuzuari vepron si anëtar i një grupi të organizuar kriminal, si rrethanë rënduese, kjo dispozitë do të ishte futur në Kapitullin III mbi dënimet (p.sh. Neni 64 dhe vijues i KPK-së mbi llogaritjen e dënimit dhe rrethanat rënduese).

Përkufizimet e grupit të organizuar kriminal, grupit të strukturuar dhe të krimeve të rënda sipas nenit 274 të KPK-së kopjojnë gati fjalë për fjalë përkufizimet sipas Rregullores së UNMIK-ut 2001/22 mbi masat kundër krimit të organizuar⁶ dhe termat e përdorur sipas nenit 2 të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional.⁷ Koncepti i Krimit të organizuar në të vërtetë është prezantuar nga Rregullorja e UNMIK-ut 2001/22. Formulimi i preambulës dhe dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut kanë për qëllim mbështetjen e qëndrimit se Krimi i organizuar është vepër penale autonome.⁸ Në përputhje me këtë, neni 5 i Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi dënueshmërinë e pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal, ofron se palët duhet të miratojnë një legjislacion të tillë dhe masat tjera të cilat mund të jenë të domosdoshme për tu përcaktuar si vepra penale, kur kryhen me qëllim: “Njëra apo të dyja si vepra penale në vijim dallojnë nga ato që përfshijnë tentativën apo përfundimin e aktivitetit kriminal: [...]”. Siç është theksuar me të drejtë nga gjykata e shkallës së dytë, edhe pse Konventa e KB-ve i lë një hapësirë palëve shtetërore që të harmonizojnë legjislacionin e tyre nacional me standardet ndërkombëtare, “[në] shumë raste të cilat bien në

⁵ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 225/2011, aktgjykimi mbi ankesën, pjesa F. Cilësimi juridik, faqet 19-20, paragrafët 99-106

⁶ Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/22 mbi masat kundër krimit të organizuar e datës 20 shtator 2001

⁷ Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional të miratuar me rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 55/25 të datës 15 nëntor 2000.

⁸ Shih *inter alia* Preambula: “ Me qëllim të krijimit të një përkufizimi të qartë mbi Krimin e organizuar në përputhje me standardet regjionale dhe ndërkombëtare siç është përcaktuar me Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Transnacional , me qëllim të krijimit të masave legjislative për ndjekjen dhe dënimin e kryerësve të krimit të organizuar, [...]”; neni 2 dënimet për kryerjen e veprave penale krim i organizuar: “2.2 Çdo person i cili kryen krim të organizuar do të jetë përgjegjës dhe do të dënohet me burgim prej pesë deri në 15 vjet dhe me gjobë deri në 500,000 DM.”

fushëveprimin e Konventës, rezultati i vetë aktivitetit kriminal do të jetë krim sipas ligjit vendorë”.⁹ Gjithashtu, vlen të përmendet se Bashkimi Evropian ka nënshkruar dhe miratuar Konventën.¹⁰

Ky qëndrim gjithashtu është konfirmuar edhe nga jurisprudenca e Gjykatës Supreme të Kosovës, të referuar në aktgjykimin e shkallës së dytë:

104. Gjykata Supreme nuk pajtohet me këtë pohim. Gjykata e Qarkut në Prishtinë, më 27 prill 2007, me aktgjykimin P. nr. 740/2005 ka shpallur të pandehurit fajtorë për akuzat e narkotikëve por ka liruar të pandehurit për akuzat e krimit të organizuar sepse ka konsideruar se akuzat e narkotikëve nuk janë “krime të rënda” – parakusht për krim të organizuar. Gjykata Supreme e Kosovës, më 2 korrik 2009, me aktgjykimin Ap. – Kz. Nr. 394/2007 ka ndryshuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut duke i cilësuar akuzat e narkotikëve si krime të rënda dhe ka shpallur të dy të pandehurit fajtorë gjithashtu edhe për akuzat e krimit të organizuar. Prandaj, Gjykata Supreme në aktgjykimin e saj ka konfirmuar se një ngjarje e vetme mund të përbëjë dy vepra penale të ndara përkundër konsumimit penal të krimit më të vogël nga ai më i rëndë. Gjykata Supreme nuk ka ndryshuar qëndrimin e saj kur ka vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë më 25 maj 2010.¹¹

Sigurisht, krimi i rëndë, krimi bazë është parakusht i veprës penale Krim i organizuar. Siç është paraparë me nenin 274 të KPK-së, krimi bazë nuk ka nevojë që të jetë kryer. Akti kriminal mund të konsumohet nëse individ i në të vërtetë kryen krim të rëndë, por gjithashtu nëse ai/ajo në mënyrë aktive merr pjesë në aktivitete kriminale apo të tjera të grupit të organizuar kriminal duke e ditur se pjesëmarrja e tij/saj do të kontribuojë në kryerjen e krimeve të rënda, ose nëse ai/ajo organizon, formon, mbikëqyr, menaxhon ose drejton aktivitetet e një grupi të organizuar kriminal. Individ mund të dënohet për Krim të organizuar edhe pse krimi bazë nuk është kryer, nëse në këtë rast janë përmbushur elementet e nevojshme të veprës penale Krim i organizuar. Ngjashëm, dënimi për krimin bazë nuk e pengon gjykatën që të shpall të pandehurin fajtorë për një vepër të veçantë të Krimit të organizuar.

Kolegji i Gjykatës Supreme pajtohet me gjetjet e shkallës së dytë se “interpretimi i saktë i nenit 274 të KPK-së është se dënimi i përcaktuar duhet t’i shtohet dënimit të shqiptuar për kryerjen e të ashtuquajturit “krimit bazë”, krimit të rëndë”.¹² Si rrjedhojë, as gjykata e shkallës së parë e as gjykata e shkallës së dytë nuk kanë bërë shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale duke shqiptuar dy dënime të ndryshme, dhe pastaj një dënim unik ndaj të pandehurit.

⁹ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 225/2011, aktgjykimi mbi ankesën, pjesa F. Cilësimi juridik, faqe 20, paragrafi 105; shih gjithashtu shembujt e ligjit krahasues: neni 129 formimi i organizatave kriminale i Kodit Penal të Gjermanisë; nenet 212-3 (krimet tjera kundër njerëzimit), 214-4, 222-34 (trafikimi i drogave) i Kodit Penal të Francës; Kapitulli 17 Veprat kundër rendit publik, neni 1 (a), pjesëmarrja në aktivitete të një organizate kriminale, Kodi Penal i Finlandës ; neni 294 (bashkimi kriminal), neni 298 (pjesëmarrja në grup i cili kryen vepra penale) i Kodit Penal të Sllovenisë

¹⁰ Nënshkrimi më 12 dhjetor 2000 dhe miratimi më 21 maj 2004

¹¹ Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 225/2011, aktgjykimi mbi ankesën, faqe 20, paragrafi 104, duke i referuar Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimit Ap-Kz nr. 394/2007 të datës 2 korrik 2009, faqe 4

¹² Gjykata Supreme e Kosovës, Ap-Kz nr. 225/2011, aktgjykimi mbi ankesë, faqe 20, paragrafi 105

Qëndrimi i lartpërmendur është gjithashtu i zbatueshëm edhe në vijim. S.P. është dënuar për Krim të organizuar sipas nenit 274 paragrafit 1 të KPK-së dhe për Blerje, posedimi, shpërndarje dhe shitje të paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm dhe të substancave psikotropike sipas nenit 229 paragrafëve 2 dhe 4 pikës 1 të KPK-së. Në mënyrë më specifike sipas pikës 1, fakti se kryerësi ka vepruar si anëtar i një grupi është rrethanë e cila duhet të merret parasysh për dënim me burgim dhe me gjobë prej tri (3) deri në pesëmbëdhjetë (15) vite. Mund të kontestohet se fakti që i pandehuri ka vepruar si “anëtar i një grupi” tanimë është përfshirë në përcaktimin ligjor të akuzës për narkotikë, prandaj i pandehuri nuk mund të dënohet edhe për pjesëmarrjen e tij në grup të organizuar kriminal nën akuzën për Krim të organizuar. Ky pretendim nuk qëndron, pasi që pika 1 në mënyrë të qartë është rrethanë rënduese me qëllim të rritjes së dënimit, kurse siç është cekur më lart, përfshirja si anëtar i një grupi të organizuar kriminal është vepër penale e ndarë.

Përfundimisht, Gjykata Supreme gjen se një sekuençë e akteve mund të ndahet në disa vepra penale përderisa të gjitha elementet e veprës penale janë përmbushur në këtë rast. Kodi nuk e ndalon një ndarje të tillë të akteve. Përkundrazi, dispozitat ligjore i japin të drejtë gjyqtarit që të vërtetojë gjendjen faktike dhe cilësimin juridik të një akti në mënyrë të saktë për ta zbuluar të vërtetën.¹³

Prandaj është vendosur si në dispozitiv.

Kryetar i kolegjit

EULEX Judge Horst Proetel

Anëtare e kolegjit

Gjyqtare e Kosovës Marije Ademi

Anëtar i kolegjit

Gjyqtar i EULEX-it Tore Thomassen

Anëtare e kolegjit

Gjyqtare e Kosovës Nesrin Lushta

Anëtar i kolegjit

Gjyqtar i EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger

Procesmbajtëse

Zyrtare ligjore Chiara Rojek

**Gjykata Supreme e Kosovës
Pkl-Kzz 80/2012
14 Qershor 2012
Prishtinë**

¹³ Shih *inter alia* nenin 386 të KPPK-së